

Të shtëna me armë në Shkodër/ Plumbi përfundon në dritaren e një banese, policia jep detajet

0 KOMENTE December 14, 2022

Të shtëna me armë janë regjistruar mbrëmjen e kësaj të mërkure në Shkodër.

Policia në një njoftim për media, bën me dije se pranë banesës së shtetasit me iniciale P.S është qëlluar një herë në ajër me armë zjarri.

Si pasojë e kësaj, predha e plumbit ka rënë në dritaren e katit të tretë, por fatmirësisht pa probleme në njerëz.

Shërbimet e Policisë vijojnë kontrollin e zonës dhe janë ngritur pika kontrolli, në të gjitha rrugët, me qëllim bllokimin e automjetit dhe kapjen e autorit.

Shkodër/Informacion paraprak

Më datë 14.12.2022, rreth orës 20:00, një shtetas ende i paidentifikuar, duke qarkulluar me automjet, në rrugën "Hilë Mosi", në lagjen "Skënderbeg", në ecje e sipër ka qëlluar një herë, me armë zjarri, në ajër.

Si pasojë predha e plumbit ka rënë në dritaren e katit të tretë të banesës së shtetasit P. S., 57 vjeç. Nga rënia e predhës nuk ka mbetur i dëmtuar asnjë person.

Grupi hetimor ka sekuestruar menjëherë pamjet e kamerave të rrugës, në të cilat dallohet drejtuesi i automjetit që ka qëlluar një herë me armë zjarri, në ajër.

Vijojnë veprimet, nën drejtimin e Prokurorisë, për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit.

Shërbimet e Policisë vijojnë kontrollin e zonës dhe janë ngritur pika kontrolli, në të gjitha rrugët, me qëllim bllokimin e automjetit dhe kapjen e autorit.

Posted Under: Aktualitet Kronike Kryesoret Vendi

Tagged: policia Shkoder Te shtena me arme

MË TË LEXUARAT

U aksidentua me makinë në Qafën e Muzinë...

Ja cilat janë femrat që kanë nevojë urgj...

Aksident tragjik në Itali, ndërron jetë...

E rëndë në Tiranë/ 61 vjeçari var veten...

"Mjaft është mjaft"/ Kryeministri britan...

Leave a Reply

Your email address will not be published. Required fields are marked *

Comment *

Name *

Email *

Website

Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

Post Comment

SUBSCRIBE VIZION PLUS TV YouTube

TË TJERA NGA AKTUALITET

Mallakastër/ I moshuari i jep fund jetës duke pirë fotoksinë më shumë...

"Ura e Zogut" drejt shembjes/ Lumi i rrëmbyer dëmton rëndë monumentin e kulturës më shumë...

SHBA: Ushtria serbe, jo në Kosovë/ Escobar kërkon heqjen e barrikadave dhe rikthimin në Institucione më shumë...

Moti i keq/ Situatë mbetet problematike në veri të vendit, disa akse të pakalueshme më shumë...

TË TJERA NGA

Mallakastër/ I moshuari i jep fund jetës duke pirë fotoksinë më shumë...

"Ura e Zogut" drejt shembjes/ Lumi i rrëmbyer dëmton rëndë monumentin e kulturës më shumë...

Përmbytje e gurë në rrugën e Arbrit në Bulqizë më shumë...

Sherr me thika në Gramsh/ 37-vjeçari niset me urgjencë te Trauma. Arrestohet autori më shumë...

© VIZION PLUS TV ALBANIA 1999 - 2022
NDALOHET RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR I PERMBAJTJES SE KESAJ FAQEJE.